Mësimi i Fesë Islame për Fëmijë

1

KLASA E PARË

Për fëmijët e moshës 6-7 vjeç

Tiranë, 2011

Titulli i plotë: **Mësimi i Fesë Islame për Fëmijë**

Përktheu nga arabishtja: **A.Zunallari**

Reçensoi: **Justinian Topulli**

Redaktoi: **Entela Hidri**

Faqosja: **A. Zunallari**

Botues: **Qendra Teuhidi & Shtepia Botuese "Teuhidi"**

Botimi i parë: **Prill 2011**

Tel: **067 21 94 241\ 067 28 21 108**

E-mail: **dzunallari@hotmail.com**

web: **www.teuhidi.com**

بسم الله الرحمن الرحيم

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit

Hyrje

Lavdërimet i takojnë Zotit, Ai që e mësoi njeriun të shkruaj me penë, i mësoi njeriut atë që nuk e dinte. Bekimet dhe paqja e Zotit qofshin me Profetin fisnik që nuk dinte shkrim e lexim, dhe të cilin Allahu i Lartësuar e dërgoi për të nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë. Teuhidi, ose ndryshe Njësimi i Zotit të Madhëruar, është detyrimi më madh i njeriut në këtë jetë, ndaj dhe kjo dije është dija më fisnike dhe më e mira ndër dije.

Mbi dijen e Teuhidit qëndrojnë të gjitha veprat e njeriut, kjo dije është peshorja që vlerëson saktësinë e një vepre dhe pranimin ose refuzimin e saj tek Zoti.

Nevoja që ka njeriu për këtë dije qëndron mbi çdo nevojë tjetër, sepse zemrat nuk mund të marrin jetë, nuk do të ndjejnë kënaqësi dhe as qetësi vetëm se duke njohur Zotin e tyre, të Adhuruarin dhe Krijuesin e tyre, dhe kjo me anë të emrave, cilësive dhe veprave të Tij madhështore.

Po kështu, njohja e mirë e fesë dhe e mënyrës sesi kryhen adhurimet, siç janë abdesi dhe namazi, është një nga shenjat e lumturisë së njeriut dhe një nga shenjat se Allahu i Madhëruar ia do të mirën njeriut. I Dërguari i Zotit (alejhi salatu ue selam) thotë: "Atij që Allahu ia do të mirën, ia mëson dhe ia bën të kuptueshme fenë."

Duke marrë për pikënisje këto arsye që përmendëm, e pamë të domosdoshme që tu paraqesim muslimanëve, prindër, mësues dhe edukator, këto mësime ku përfshihen njohja e Zotit dhe mësimi i fesë, në përshtatje me moshën e fëmijëve që ata kanë nën kujdes. Ne shpresojmë se këto mësime, me ndihmën e Zotit, do të ndihmojnë shumë që fëmijët tanë të rriten dhe edukohen me frymën e besimit të drejtë, me njohjen e normave të fesë, si dhe do të jenë të aftë të kryejnë adhurimet ashtu siç i kërkon Islami.

Është mjaft e rëndësishme që një musliman të njoh mirë dhe të kuptojë qartë çështjet e fesë së tij.

Ky libër përmban:

***Lëndën e Teuhidit**:* pasi fëmija ka mësuar në ciklin parashkollor bazat fillestare të tre parimeve të fesë, të cilat duhet t'i njohë një njeri, në këtë libër ai do të njihet me një shpjegim më të zgjeruar të këtyre parimeve si dhe të tre niveleve të besimit.

Lëndën e Fikhut: pasi fëmija ka mësuar në ciklin parashkollor rregullat që kanë të bëjnë me pastërtinë dhe namazin, në këtë libër këto gjëra do të shtjellohen më gjatë, për t'i ardhur në ndihmë atij të kryej detyrimet e fesë në mënyrën sa më të mirë.

Në këtë libër janë pasur parasysh qëllimet e çdo mësimi duke u kujdesur që shprehjet të jenë sa më të përmbledhur dhe sa më të qarta si dhe temat të jenë të përshkallëzuara dhe të lidhura ndërmjet tyre dhe me ato çka fëmija ka mësuar më parë.

Në çdo mësim kemi vendosur Diskutime, për t'i ardhur në ndihmë prindërve, mësuesve dhe edukatorëve, në mënyrë që mësimi të përmbush qëllimet e kërkuara.

Këshilla të dobishme për prindërit, mësuesit dhe edukatorët:

1-Sinqeriteti ndaj Zotit është kusht për pranimin e punëve nga ana e Tij. Bëje punën tënde sinqerisht për hir të Allahut të Madhëruar, që të fitosh kënaqësinë e Tij në këtë botë dhe në botën tjetër.

2-Mbajtja e përgjegjësisë është çelësi i suksesit. Çdo njeri prej nesh ka një detyrim të caktuar ndaj fesë së tij, një nga detyrimet që ka një prind apo një edukator musliman karshi brezit të ri është përgjegjësia për edukimin intelektual të brezit të ri të muslimanëve. Mbaje siç duhet këtë përgjegjësi që të është besuar, për të fituar lumturinë në këtë botë dhe në tjetrën.

3-Mësimi i Teuhidit është një veprat më të mira që bën njeriu, nuk ka lumturi dhe shpëtim për njeriun nga trishtimi i kësaj bote dhe ndëshkimi i botës tjetër vetëm se duke njohur Zotin dhe mënyrën se si njësohet Ai. Puno me gjithë shpirt për të mbjellë në shpirtin e brezit të ri besimin e drejtë dhe bëhu një shembull besnik e i gjallë i vlerave dhe virtyteve të larta.

4-Shfrytëzo ngjarjet dhe situatat e ndryshme, për të folur për njëjësinë e Zotit, fuqinë e Tij, p.sh. kur retë grumbullohen në qiell, kur vezullon vetëtima, kur buçet bubullima, kur bie shiu, si dhe në të tjera situata të ngjashme, të cilat ngacmojnë te fëmijët ndjenjën e besimit.

5-Mësimi i Fikhut është një nga detyrat më të rëndësishme për një besimtar, sepse një fëmijë musliman mëson sesi ai duhet të kryej adhurimet e detyrueshme, siç është pastrimi vetjak, abdesi, namazi, si dhe normat e rregullat e tjera fetare, ndaj duhet që ju si mësues, edukator dhe prindër t'i edukoni fëmijët në praktikë, atë çka u mësoni në teori.

6-Thjeshtimi i materialit fetar duke dhënë sa më shumë shembuj, duke e lidhur atë me realitetin ka një ndikim shumë të madh në dashurinë që fëmijët tregojnë ndaj këtij mësimi dhe për rrjedhojë edhe përthithjen e tij në mënyrën më të mirë.

Duke e mbyllur ju përgëzojmë me fjalën e Profetit (alejhi salatu ue selam) që thotë: "Një nga veprat dhe mirësitë që e pasojnë besimtarin pas vdekjes së tij është dhe një dije që ai e ka dhënë mësim dhe ka përhapur atë."

Pasqyra e lëndës

Teuhidi


	Temat	Fq
Mësimi I	Detyrat e domosdoshme që duhet t'i dije ç'do musliman dhe muslimane	10
Mësimi II	Zoti im është Allahu	12
Mësimi III	Njohja e Zotit	14
Mësimi IV	Allahu është Krijuesi	16
Mësimi V	Disa prej mrekullive të Allahut në krijesat e Tij.	20
Mësimi VI	Allahu është Furnizuesi	21
Mësimi VII	Adhuroj vetëm Allahun, Ai është Zoti im.	25
Mësimi VIII	Feja ime është islami	27
Mësimi IX	Profeti im është Muhamedi (alejhi selam)	31
Mësimi X	Kur'ani Fisnik	35

Fik'hu

	Temat	Fq
Mësimi I	Pastërtia	38
Mësimi II	Si merret abdesi.	41
Mësimi III	Namazet e detyrueshme.	46
Mësimi IV	Mënyra e faljes së namazit	50
Mësimi V	Teshehudi	56
Mësimi VI	Salavetet për të Dërguarin e Allahut (alejhi salatu ue selam)	59
Mësimi VII	Veprimet që e prishin namazin	61

التوحيد TEUHIDI

Detyrat e domosdoshme që duhet t'i dijë ç'do musliman dhe muslimane



Plotëso vendet bosh me fjalë të përshtatshme:

Zoti im është .....

Feja ime është .....


Profeti im është .....

Unë kujdesem që ta them këtë dua tri herë në mëngjes dhe tri herë në mbrëmje:

***"Zoti im është Allahu, feja ime është Islami dhe profeti im është Muhamedi** (alejhi salatu ue selam)."*







a) *Shpjegojua nxënësve mirësitë e mëdha që Allahut u ka dhuruar njerëzve.*

b) *Shpjegojua nxënësve mirësinë e Allahut ndaj robërve të tij, duke u dërguar atyre Profetë për t'i udhëzuar që ata të fitojnë lumturinë në të dy botët.*

c) *Shpjegojua nxënësve bukurinë dhe madhështinë e fesë islame.*

d) *Shpjegojua nxënësve se Allahu është i kënaqur që robërit e Tij të praktikojnë vetëm fenë islame dhe se feja e vetme e pranuar nga Allahu është Islami.* ***(Suretu Maide 3)***

e) *Ngulit në zemrat e nxënësve dashurinë dhe krenarinë për fenë islame.*

Objektivat e mësimit:


- ***T'iu qartësohet nxënësve se çfarë ka për detyrë të mësojë muslimani.***
- ***Nxënësi duhet të ndjehet i lumtur dhe krenar me fenë islame.***

Zoti im është Allahu





1. ***Kush është Zoti yt?.***
2. ***Ku është Allahu?.***
3. ***Kush të krijoi dhe u kujdes për ty që ti të rritesh i shëndetshëm me mirësinë e Tij?.***



a)*Referoju hadithit të robëreshës, të cilën e pyeti i Dërguari i Allahut (alejhi salatu ue selam) se ku është Allahut, ajo u përgjigj dhe tha:-Në Qiell…*(Transmeton Muslimi nr 5307)

b) *Shpjegojua kuptimin e shprehjes: Kujdeset për mua që të rritem me mirësinë e Tij.*

c) *Sqarojua nxënësve se çfarë qëllimi ka fjala: "Më furnizoi me mirësi të dukshme (Mirësia e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies) dhe të padukshme (Mirësinë e besimit dhe e udhëzimit)."*

d) *Sqarojua nxënësve që Allahu është lart në qiell.*

e) *Përmendua nxënësve disa nga mirësitë e Allahut.*

Mësimi i tretë

Njohja e Zotit.




Unë e njoh Allahun nga argumentet e Tij dhe krijesat e Tij si nata, dita, qiejt dhe toka.

Allahu më solli në jetë, pastaj ma merr shpirtin dhe tek Ai është kthimi im.

Diskutim:

1. ***Me çfarë argumentesh e njeh Zotin tënd?***

2. ***Kush të solli në jetë?***



a) *Përmend disa shembuj nga shenjat e Allahut si psh.: rënia e shiut, rritja e bimëve, përgjigjja e duasë, largimi i brengave etj.*

b) *Kërkojua nxënësve të meditojnë rreth krijesave të Allahut.*

Objektivat e mësimit:

- ***Fëmijëve duhet t'u përmenden disa argumente në krijesat e Allahut.***
- ***Nxënësit duhet të meditojnë në mrekullitë, që kanë krijesat e Allahut.***
- ***Fëmijëve duhet t'u bëhet e qartë që Allahu ka fuqi për çdo gjë dhe do t'i ringjall të gjithë njerëzit që kanë vdekur.***

Allahu është Krijuesi

Allahu më krijoi mua dhe të gjithë njerëzit, Allahu krijoi qiejt dhe tokën, Allahu krijoi natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën.




Ushtrime

Plotëso vendet bosh me fjalët e përshtatshme:

1)…….....është Krijuesi i njerëzve dhe i çdo gjëje.

2)……..……..është Krijuesi i qiellit dhe i tokës.

3)……..……..është Krijuesi i Diellit dhe i Hënës.



a) *Shpjegoju nxënësve se madhështia e krijesave është argument për madhështinë e Krijuesit dhe se vetëm Allahu e meriton të adhurohet.*

b) *Është e pëlqyeshme që ora e mësimit tëzhvillohet jashtë klase në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi të shikojnë disa nga krijesat e Allahut si: Qielli, Toka, pemët, etj. dhe tëmeditojnë rreth tyre.*

c) *Kërkoju nxënësve të japin shembuj të tjerë nga krijesat e Allahut.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësi duhet të nxitet për të menduar rreth krijesave të Allahut, në mënyrë që të ndjejë madhështinë e Krijuesit.***
- ***Nxënësve duhet t'u bëhet e qartë se Allahu i krijoi njerëzit nga asgjë dhe se pas vdekjes së tyre, Ai është i plotfuqishëm për t'i ringjallur ata përsëri.***

4

Allahu është Krijuesi

Allahu është Ai që krijoi malet, detet, pemët dhe çdo gjë që është në tokë dhe në qiell. Allahu i Lartësuar thotë: "Allahu është Krijuesi dhe Ai është mbikëqyrës i çdo gjëje." *Suretu Zumer 62*



Diskutim:

1. *Përmend tri nga krijesat e Allahut.*
2. *Ne kemi mësuar që Allahu është Krijuesi i çdo gjëje, cili është argumenti për këtë që themi?*

a) *Allahu i Lartësuar ka thënë në suretu Junuz 5 :*

"Ai e ka bërë Diellin burim drite, kurse Hënën e ka bërë të shkëlqejë, duke i caktuar asaj fazat, që ju të dini numrin e viteve dhe njehsimin e kohës."

● *Plotëso vendet bosh:*

Prej dobive që ne përfitojmë nga dielli janë:.....

Prej dobive që ne përfitojmë nga hëna janë: .....



a) *Qartësojua nxënësve se adhurimi i përket vetëm Allahut. Ai është Krijuesi i çdo gjëje.*

b) *Përmendju nxënësve dobitë e disa prej krijesave të Allahut.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësve duhet t'u qartësohet se adhurimi i përket vetëm Allahut.***
- ***Nxënësve duhet t'u përmenden disa nga krijesat e Allahut.***

Disa prej mrekullive të Allahut në krijesat e Tij.



"Ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e Qiejve dhe të Tokës (duke thënë): "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto, lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit." Suretu Ali Imran 191

Krijuesi i çdo gjëje e meriton të adhurohet.



a) *Shpjegojua nxënësve madhështinë e disa prej krijesave të Allahut, duke marrë parasysh moshën e tyre.*

b) *Sqarojua nxënësve se meditimi në shenjat e Allahut, ia shton besimin muslimanit, ia shton njohjen dhe dashurinë për madhërimin ndaj Zotit të tij.*

c) *Tregojua nxënësve disa nga përfitimet që kanë njerëzit nga këto krijesa.*

Objektivat e mësimit:

- ***T'u sqarohen nxënësve disa nga aspektet e madhështisë së krijesave të Allahut.***
- ***Nxënësit duhet të meditojnë rreth shenjave të Allahut dhe rreth krijesave të Tij.***

Allahu është Furnizuesi

Allahu e lëshon shiun nga qielli.





Allahu na furnizon me ushqim dhe pije.

Allahu na dhuroi dëgjimin dhe shikimin.




Diskutim:

1 **Kush na furnizon me ushqim dhe pije?**

a. *Plotëso vendet bosh:*

- ***Nga shikimi kemi këto përfitime: ……***
- ***Nga dëgjimi kemi këto përfitime: ……..……..***



a) *Përmendjua disa dobi që kemi nga shiu.*
b) *Kërko nga nxënësit që të jenë te kujdesshëm, të mos e shpërdorojnë ujin gjatë përdorimit.*
c) *Shpjegojua nxënësve dobitë e dëgjimit dhe të shikimit.*
d) *Shpjegojua nxënësve se Allahu na ka begatuar me mirësi të mëdha si: dëgjimi, shikimi, ushqimi, pijet, veshmbathjet, strehimi etj. Ai na i ka dhënë të gjitha këto që të na forcojë besimin për t'iu bindur vetëm Atij.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësit duhet të njihen me disa prej mirësive të Allahut.***
- ***Nxënësit duhet të falënderojnë Allahun për këto mirësi.***

6

Allahu është Furnizuesi.

Allahu na dhuroi shëndet dhe siguri

"Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi." ***Suretu Dharijat 58***

Atëherë është detyrim për mua, të falënderoj Allahun, i Cili më furnizoi me çdo gjë që më nevojitet.



Diskutim:

1. *Kush na furnizon ne me çdo mirësi?*
2. ***Përshkruaj nga figurat e mëposhtme dy nga mirësitë e Allahut!***

a. *Plotëso vendin bosh:*

Muslimani e falënderon Zotin e tij pas çdo mirësie dhe thotë: ……...

a. **Çfarë ndodh me tokën pasi bie shiu?**
(.....)

Çfarë ndodh me tokën nëse nuk bie shi?
(.....)







a) *Shpjegojua nxënësve se vetëm Allahu është ai që jep rrisk.*
b) *Nxënësit duhet të mësohen që t'i luten Allahut për shëndet dhe siguri.*
c) *Nxënësit duhet të mësohen që të falënderojnë Allahun pas çdo mirësie.*
d) *Disa nga besimtarët e parë kanë thënë:*
"Rikujtimi i të mirave shton dashurinë ndaj atij që ta ka dhënë atë të mirë."

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësve duhet t'u jepen argumente se Allahu është Furnizues.***
- ***Nxënësit duhet të kuptojnë se duhet falënderuar vetëm Allahu për ato mirësi të mëdha që i posedojmë.***

Adhuroj vetëm Allahun.
Ai është Zoti im.

Unë jam musliman dhe adhuroj vetëm Allahun.

Unë jam musliman e dua Allahun dhe i bindem urdhrave të Tij.

Unë jam musliman e kam frikë Allahun dhe nuk i kundërshtoj urdhrat e Tij.

Unë jam musliman i lutem vetëm Allahut dhe nuk i lutem askujt tjetër veç Tij.

Diskutim:


1 **Kush e meriton të adhurohet?**

a. Plotëso vendet bosh me fjalë të përshtatshme.

Muslimani i lutet vetëm……...

Muslimani kujdeset që të falë çdo …….. në kohën e vet.

Muslimani lexon vazhdimisht……...që të fitojë kënaqësinë e Allahut të Lartësuar dhe të hyjë në ……



a) *Shpjegojua nxënësve, duke marrë parasysh moshën e tyre, që Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Ai që ngjall dhe vdes, dhe vetëm Ai meriton të adhurohet.*
b) *Përmendua disa lloje adhurimi si: Namazi, agjërimi, lutja, kurbani,...etj*
c) *Përkujtojua nxënësve shpërblimet e përgatitura për ata që bëjnë vepra të mira.*
d) *Përkujtojua nxënësve shpërblimet e përgatitura për ata që bëjnë vepra të mira.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësi duhet të kuptojë se duhet adhuruar vetëm Allahu.***
- ***Nxënësi duhet të mësojë disa lloje adhurimi.***
- ***Nxënësi duhet të kuptojë dëmin e bërjes së veprave, të cilat e zemërojnë Allahun.***

Feja ime është islami

Unë jam musliman, feja ime është Islami.

"Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami."

Suretu Ali imran 19

Islami është:

"Njësimi i Allahut, bindja ndaj Tij, lënia e gjynaheve dhe largimi nga çdo fe tjetër përveç fesë islame"

Diskutim:

1. Cila është feja jote?

a. *Lidh me laps fjalët e kolonës së parë me fjalët e përshtatshme të kolonës së dytë.*

Islami është:

Njësimi	përveç islamit
Lënia	e gjynaheve
Largimi nga çdo fe	i Allahut



a) *Qartësoua kuptimin e fjalës islam dhe ngulit në zemrat e nxënësve dashurinë për këtë fe.*
b) *Përmendua disa prej përfitimeve që kanë njerëzit nga feja islame.*
c) *Shpjegojua se praktikimi i Islamit është shkaku i vetëm për fitimin e Xhenetit dhe largimin nga zjarri.*
d) *Sqarojua nxënësve se feja islame na urdhëron që t'i duam të gjithë muslimanët.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësve duhet t'u sqarohet kuptimi i Islamit.***
- ***Nxënësit duhet të ketë dashuri për muslimanët.***
- ***Nxënësit duhet të kuptojnë rrezikun e shirkut dhe të largohen prej tij.***

Feja ime është Islami

Themeli i Islamit: Është dëshmia se: Askush tjetër nuk e meriton të adhurohet përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

Çdo fe tjetër përveç Islamit nuk është e pranuar nga Allahu.

"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur." *Suretu Ali Imran 85.*

Atëherë unë jam musliman dhe nuk pranoj fe tjetër përveç Islamit.

Diskutim:

1. **Cili është themeli i Islamit?**

2. Plotëso vendet bosh me fjalët e përshtatshme (islamit, zjarr)

Çdo fe tjetër përveç……...është e kotë dhe kush vdes në fe tjetër përveç islamit, ai hyn në……...

3. Allahu nuk pranon fe tjetër përveç Islamit. Trego një argument për këtë?

4. Vendos shenjën √ në veprimin ku muslimani thotë shehadetin.

Në ezan	gjatë ushqimit	pasi mbaron abdesin	pas teshtimës.
○	○	○	○



a) Gjatë shpjegimit të mësimit referoju hadithit të Muadhit, kur i Dërguari i Allahut e dërgoi te banorët e Jemenit. Ai e urdhëroi që gjëja e parë që do t'i ftonte njerëzit të ishte shehadeti. *Transmeton Buhariu nr 7372 dhe Muslimi nr 19.*
b) Shpjegojua nxënësve rëndësinë e dy dëshmive .
c) Jep shembuj për fe të tjera si: Të krishterët, jehudët, adhuruesit e idhujve etj.
d) Sqarojua nxënësve se ata që vdesin në fe tjetër përveç Islamit, përfundimi i tyre është në zjarr.

Objektivat e mësimit:

- **Nxënësi duhet të mësojë themelet e Islamit.**
- **Nxënësi duhet të ketë të qartë se asnjë fe tjetër përveç Islamit, nuk është e pranuar tek Allahu.**

Profeti im është Muhamedi (alejhi selam)

Allahu atë e dërgoi për të gjithë njerëzit.

Allahu e dërgoi këtë Profet që t'i ftojë të gjithë njerëzit të adhurojnë vetëm Allahun dhe të largohen nga adhurimet e të tjerëve veç Tij.


Diskutim:

1. *Plotëso vendet bosh me fjalë të përshtatshme të përdorura në fjalitë e mësipërme.*

Emri i të Dërguarit të Allahut është: .....

Allahu e dërgoi për të gjithë .....

Allahu e dërgoi që t'i ftojë *të gjithë ……..,që të adhurojë vetëm Allahun dhe të largohen nga adhurimet ……..…. veç Tij.*



a) *Shpjegojua nxënësve se pjesë e mëshirës së Allahut për njerëzit është edhe dërgimi i Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), për t'i udhëzuar ata në rrugën e drejtë.*

b) *Sqarojua nxënësve se dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), ka të bëjë me bindjen ndaj urdhrave të tij dhe pasimin e tij.*

c) *Sqarojua nxënësve që sa herë që përmendet emri i Tij, duhet të bëhen salavate për të.*


d) *Tregojua historinë e lindjes së Profetit (alejhi salatu ue selam) në Vitin Elefantit, në një mënyrë të përshtatshme dhe edukative për nxënësit.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësit duhet të mësojnë prejardhjen e të Dërguarit të Allahu (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).***
- ***Nxënësit duhet të mësojnë se i Dërguari i Allahut Muahamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) është dërguar për të gjithë njerëzit.***
- ***Nxënësve duhet t'u bëhet e qartë urtësia e dërgimit të Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).***

Profeti Muhamed (alejhi selam)

Kush i bindet të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) hyn në xhenet.



Kush e kundërshton të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) hyn në zjarr.

Atëherë

është obligim për mua, që ta dua të Dërguarin e Allahut dhe t'i bindem atij.

Diskutim:

1. *Plotëso vendet bosh.*

Kush i bindet të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) **hyn .....,** **Kush e kundërshton të Dërguarin e Allahut** (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) **hyn .....**

Prej cilësive të profetit është: .....

2. **Ç'farë thuhet kur përmendet emri të Dërguarit të Allahut** (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).....



a) *Këshilloji nxënësit që t'i binden të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), ta duan atë dhe të mos i kundërshtojnë urdhrat e Tij.*

b) *Shpjegojua nxënësve se kush e do të Dërguarin e Allahut është me të në Xhenet. Është transmetuar në një hadith se "Njeriu është me atë që do" transmeton Buhariu nr 6169*

c) *Tregoju diçka për moralin e të dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) si: Sinqeriteti, besnikëria, mëshira me shembuj nga jeta e tij, që nxënësve t'u shtohet më shumë dashuria dhe dëshira për ta ndjekur atë.*

d) *Tregoju shembuj nga jeta e sahabëve për dashurinë dhe bindjen që kishin ndaj të dërguarit(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësve duhet t'u bëhet e qartë, që dashuria ndaj të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) shprehet me bindjen dhe pasimin e tij.***
- ***Duhet t'u bëhet e qartë se kush i bindet të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) hyn në xhenet dhe kush e kundërshton hyn në zjarr.***
- ***Nxënësve duhet t'u bëhet i qartë rreziku i kundërshtimit të të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)***



Kur'ani Fisnik



***Allahu i Lartësuar ia ka zbritur Kur'anin Muhamedit** (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)*

Kur'ani është fjala e Allahut.

Është obligim për ne që ta duam Kur'anin, ta lexojmë dhe të veprojmë sipas tij.

Diskutim:

1. **Cilin libër Allahu ia zbriti të Dërguarit Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)?**

2. *Plotëso vendet bosh me fjalët e përshtatshme.*

Unë jam musliman dhe Libri im është……..Fisnik.
I Dërguari i Allahut ka thënë: "Më i miri prej jush është ai që ……..Kur'anin dhe ua mëson atë të tjerëve."

Unë e kam mësuar ajetin Kursij dhe e lexoj pas çdo namazi si dhe para gjumit.



a) *Tregojua nxënësve për shpërblimet me sevape nga leximi i Kur'anit dhe mësimin përmendësh të tij.*
b) *I Dërguari i Allahut ka thënë: "Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson atë edhe të tjerëve"* Transmeton Buhariu nr 5027
c) *Gjithashtu i Dërguari i Allahut thotë: "Kush lexon nga libri i Allahut një shkronjë ka një shpërblim dhe një shpërblim dhjetëfishohet. Nuk them që Elif-lam-mim është një shkronjë, por elif një shkronjë, lam një shkronjë, mim një shkronjë"* Transmeton Tirmidhiu nr 2910.
d) *Është e detyrueshme që Kur'ani të respektohet dhe leximi i tij të dëgjohet me vëmendje. Argument për këtë është fjala e Allahut: "Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni."* Suretu el-Araf: 204
e) *Përmend disa nga emrat e Kuranit si: Edh-dhikr (Përkujtuesi), El-furkan (dalluesi), El-Kitab (Libri).*

Objektivat e mësimit:


- ***Nxënësi duhet të kuptojë se Kur'ani është fjala e Allahut.***
- ***Nxënësi duhet të kuptoje urdhrat që janë në Kur'an.***
- ***Nxënësi duhet të kuptojë ndalesat që janë në Kur'an.***

FIK'H

الفقه

Mësimi i parë

Pastërtia



Pastërtia është detyrë

Allahu i lartësuar na ka urdhëruar që të pastrohemi.

Ne e kemi për detyrë që të pastrohemi me ujë të pastër pas kryerjes së nevojave personale.



Pjesë e pastërtisë është

Abdesi, ne e kemi për detyrë që të marrim* abdes me ujë të pastër para faljes së namazit.



Pjesë e pastërtisë është

Largimi i ndyrësive nga trupi, rrobat dhe vendi i faljes.



Diskutim:

a. *Vendos shenjën √ para fjalisë së saktë dhe shenjën x para fjalisë jo të saktë.*

Falim namazin pastaj marrim abdes ⬭	**Marrim abdes pastaj falim namazin** ⬭

b. *Plotëso vendet bosh.*

Unë marr abdes me .....të pastër.

c. *Nënvizo fjalën e cila e pastron rrobën nga papastërtia.*

Uji	**Dheu**


d. *Plotëso fjalitë e mëposhtme.*

Pas kryerjes së nevojave personale pastrohem me ..... të pastër.

Para se të fal namaz marr abdes me..... të pastër.

a. *Shkruaj fjalitë e mëposhtme.*

1. ***Namazi nuk pranohet pa abdes dhe abdesi nuk vlen pa ujë të pastër.***
2. .....
.....
3. ***Namazin nuk e fal në vende të papastra.***
4. .....
5. ***Para fillimit të namazit kujdesem, që rrobat, trupin dhe vendi ku do të falem të jenë të pastra.***
6. .....
.....



a) *Sqarojua nxënësve cilësitë e ujit të pastër duke dhënë shembuj për të.*
b) *Sqarojua nxënësve se pas nevojave personale lejohet pastrimi me gurë apo letra higjienike etj., kur nuk ka ujë.*
c) *Mësojua nxënësve që të përdorin dorën e majtë gjatë pastrimit të papastërtive.*
d) *Tregojua disa ajete si argument për pastrimin.*
e) *Mësojua duanë e hyrjes dhe daljes nga banja.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësve duhet t'u bëhen të qarta cilësitë e ujit me të cilin mund të pastrohen dhe të marrin abdes me të.***
- ***Nxënësve duhet t'u bëhet e qartë se çfarë është e detyrueshme të veprohet, pas kryerjes së nevojave personale.***
- ***Nxënësve duhet t'u tregohen se cilat janë kushtet që duhet të plotësohen, para fillimit të faljes së namazit.***

Mësimi i dytë

Si merret abdesi.

Enesi tha:

Unë jam musliman dhe gjithmonë marr abdes para namazit.

Umeri e pyeti:

Si merret abdesi o Enes?

Enesi përgjigjet:

Pasi bëj nijetin me zemër veproj si më poshtë:



Them “Bismilah”

Laj duart tri herë



Shpëlaj gojën dhe hundën tri herë.




Laj fytyrën tri herë.



Laj krahun e djathtë pastaj të majtin, nga majat e gishtave deri mbi bërryla tri herë.



Fërkoj kokën dhe pastaj veshët me duar të lagura, vetëm një herë.





Në fund laj këmbën e djathtë pastaj të majtën nga tri herë.



Umeri tha:

-Allahu ta shpërbleftë me të mira o Enes.

Mënyra e marrjes së abdesit.

Diskutim:

a. *Shëno me laps vendin e larjes së krahëve dhe këmbëve në dy figurat e mëposhtme:*



.....



.....

Udhëzime për mësuesin:

a) *Gjatë shpjegimit të mësimit përqendrohu tek udhëzimet e mëposhtme.*
b) *Së bashku me nxënësit shkoni në xhaminë më të afërt.*
c) *Pastaj merr abdes përpara nxënësve, që t'u përforcohet përvetësimi i mësimit duke parë mësuesin.*
d) *Trego kujdes të veçantë gjatë shpjegimit të mësimit, sidomos në kufijtë e çdo gjymtyre e cila duhet të lahet.*
e) *Pas shpjegimit të mësimit angazho disa nxënës, që të marrin abdes para shokëve të tyre.*
f) *Pyeti disa prej tyre të caktojnë kufijtë, se deri ku është obligim larja e gjymtyrëve.*
g)*Dhe në fund përsërite dhe një herë abdesin para të gjithë fëmijëve dhe pyeti ata që të bindesh se ata e kanë përvetësuar mësimin.*

a. *Vendos numrat në figurat e mëposhtme, sipas radhës së veprimeve gjatë marrjes së abdesit.*

Laj fytyrën	Shpërlaj gojën dhe Hundën	Laj këmbët deri në nyje
I jap mes'h kokës dhe veshëve	Laj krahët deri në bërryla	Laj duart

b. *Shkruaj fjalitë e mëposhtme.*

Para se të filloj të marr abdes them: "Bimilah".

.....

Unë marr abdes me ujë të pastër.

.....

Unë i laj sipas radhës gjymtyrët e abdesit.

.....

Unë nuk lë vend pa lagur në gjymtyrët e abdesit.

.....

Biri im merr abdes dhe fale namazin. Dhe falu vetëm për Zotin tënd që të fitosh kënaqësinë e Tij
Dhe kur Allahu kënaqet me muslimanin,
e bën atë të lumtur gjatë gjithë jetës së tij.

Pas përfundimit të abdesit them:

"Esh-hedu en lá iláhe il-l-Alláh, uahdehu lá sheríke leh, ue esh-hedu enne Muham-meden abduhú ue resúluh."

- Dëshmoj se askush tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut Një, të Vetëm dhe të Pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.



a) *Shpjegojua nxënësve se larja e gjymtyrëve është detyrim vetëm një herë.*
b) *Mësojua nxënësve duanë që thuhet pas përfundimit të abdesit.*
c) *I Dërguari i Allahut ka thënë: "Kush merr abdes mirë e mirë dhe pastaj thotë: -Dëshmoj se askush tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut Një, i Vetëm dhe i Pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. O Allah më bëj prej atyre që pendohen dhe më bëj prej atyre që pastrohen, - Atij i hapen tetë dyert e Xhenetit dhe hyn ku të dojë."*
d) *Sqarojua nxënësve mirësitë e ujit. Kujdesin që duhet të kemi për të dhe mos shpërdorimin e tij.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësve duhet t'u bëhen të qarta cilësitë e ujit me të cilin merret abdes.***
- ***Nxënësi duhet të qartësohet për vendin dhe mënyrën e të bërit nijet.***

Mësimi i tretë


Namazet e detyrueshme.

Namazi është shtylla e dytë e Islamit, pas dy dëshmive.

Namazet e detyrueshme gjatë një ditë-nate janë 5 dhe ato janë:



Sabahu	Dreka	Ikindia	Akshami	Darka
Dy rekate	katër rekate	katër rekate	tre rekate	katër rekate
2	4	4	3	4



Diskutim:

a. *Plotëso vendin bosh me një prej shtyllave të Islamit.*

Shtyllat e Islamit janë:

Dy dëshmitë, ……., Zekati, Agjërimi i Ramazanit dhe Haxhi.

b. *Rendit namazet e detyruara nga fillimi i ditës:*

Darka	Dreka	Akshami	Ikindia	Sabahu

c. *Lidh çdo namaz me numrin e rekateve që i përshtatet.*

Sabahu	Ikindia	Dreka	Darka	Akshami
4	3	2	4	4

d. *Shëno me laps përgjigjen e saktë:*

Filloj çdo mëngjes me namazin e:

Drekës **Sabahut**

a. *Ngjyros me të njëjtën ngjyrë namazet që kanë nga katër rekate:*

Sabahu **Dreka** **Ikindia** **Akshami** **Darka**

b. *Qarko namazin që ka tre rekate:*

Sabahu **Dreka** **Ikindia** **Akshami** **Darka**

c. *Qarko me laps namazet që falen ditën:*

Sabahu **Dreka** **Ikindia** **Akshami** **Darka**

d. *Ngjyros namazet që falen natën.*


Akshami Dreka

Ikindia Sabahu

Darka

a. *Shkruaj fjalitë e mëposhtme:*

- ***Unë asnjëherë nuk e vonoj namazin, por e fal atë në kohën e vet.***
- .....
  .....
- ***Falja e namazit në kohën e vet, është shkak për të hyrë në xhenet.***
- .....
  .....
- ***Kur e fal namazin me xhemat, ndjek imamin në të gjitha veprimet që bën ai në namaz.***
- .....
  .....



a) *Shpjegojua nxënësve se shtyllat e Islamit janë pesë.*
b) *Sqarojua nxënësve se namazet e detyruara janë 5, por në shpërblim janë 50.*
c) *Kërkojua nxënësve që të jenë të kujdesshëm me kohët e namazeve, sepse namazi është shtyllë e Islamit dhe është shkaku kryesor i hyrjes në Xhenet. Braktisja*
e) *tij është prej shkaqeve që e shpien njeriun në zjarr.*
d) *Transmetohet nga Burajde (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Marrëveshja që kemi në mes nesh dhe atyre është namazi, kush e lë atë ka bërë kufër (mohuar)"* *Transmeton Tirmidhiu nr 2721*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësve duhet t'u bëhet e qartë rëndësia e namazit në Islam.***
- ***Nxënësit duhet tu përmenden namazet e detyruara (farze) gjatë një ditë-nate.***
- ***Nxënësi duhet të mësojë numrin e rekateve të çdo namazi.***

Mënyra e faljes së namazit

Enesi dëgjoi ezanin, mori abdes dhe u çua për të pyetur si të falet. Ai pyeti Umerin si ta falë namazin?

Umeri i tha:

1-*Në fillim drejtohu nga Qabja*



2-*Pastaj thuaj: "***Allahu ekber"** *dhe qëndro në këmbë duke shikuar në vendin e sexhdes.*



3-*Pastaj lexo suren el-Fatiha dhe pas saj një sure tjetër nga Kur'ani.*




4-*Pastaj thuaj: Allahu ekber, dhe bjerë në ruku dhe thuaj: "***Subhane Rabijel-Adhim"**
(I pa të meta është Zotim im Madhështor) *tri herë.*



5-*Pasi të ngrihesh nga rukuja thuaj:*
"Semiall-llahu limen hamideh, Rab-bena ue lekel hamd. "
(Allahu e dëgjon atë që lavdëron Atë. Zoti ynë Ty të përket lavdërimi)




6-*Përsëri thuaj: "***Allahu ekber"** *dhe bjerë në sexhde, aty thuaj:*
- **" Subhane rab-bijel aë'la "**
I Pastër nga çdo e metë është Zotin im më i Larti. (tri herë)



7-*Pastaj çohesh nga sexhdja duke thënë* **"Allahu Ekber"** *dhe qëndron ulur dhe thua:* **"Rabbi-gfir lí, Rabbi-gfir lí"**
- O Zoti , më fal mua. O Zoti , më fal mua!



8-*Bjerë për herë të dytë në sexhde duke thënë* **"Allahu Ekber"** *dhe thua në sexhde:*
- **"Subhane rab-bijel aë'la"** *(tri herë)*



9-*Çohu në rekatin e dytë duke thënë:*
"All-llahu Ekber " *dhe vepro siç veprove në rekatin e parë.*



10-Pas sexhdes së dytë në rekatin e dytë them **Allahu ekber,** *nuk çohem në këmbë, por rri ulur në ndenjen e parë (teshehudin).*




11-Pastaj veproj në pjesën e mbetur siç kam vepruar në rekatët e mëparshëm, por në rekatet e mbetur lexohet vetëm surja el-Fatiha.

12-Pas sexhdes së dytë në rekatin e fundit rri ulur dhe lexoj teshehudin e fundit, bëj salavatet mbi Profetiin (alejhi salatu ue selam) pastaj jap selam nga e djathta dhe pastaj nga e majta duke thënë:

"Es-selamu alejkum ue rahmetull-llah"





a) *Mësimi duhet të shpjegohet sipas udhëzimeve të mëposhtme:*

b) *Mësuesi së bashku me nxënësit të shkojnë në faltoren e shkollës, apo në xhaminë më të afërt.*

c) *Pastaj mësuesi e fal namazin para nxënësve duke u sqaruar se çfarë thuhet në çdo rekat.*

d) *Pas shpjegimit praktik të namazit nxjerr disa nxënës para shokëve të klasës që të falin namazin, ndërsa disa të tjerë i ngarkon që të bëjnë korrigjime nëse ka gabime.*

e) *Pastaj duhet të ripërsëritet në mënyrë praktike dhe teorike shpjegimi i faljes së namazit, derisa nxënësit ta përvetësojnë mirë atë.*

Diskutim:

a. *Ngjyros përgjigjen e saktë*

- ***Gjatë faljes së namazit kur jam në këmbë shikoj në:***

Në tavan	Në mur	Vendin e sexhdes
○	○	○

- ***Në ruku them:***

Subhane rab-bijel aë'la.	Subhane rabijel-Adhim
○	○

- ***Në ruku i vendos duart mbi:***

Kofshë	Gjunjë
○	○

- ***Figura që tregon për kiblen e muslimanëve është:***





○ ○ ○

a) *Lidh shprehjet e kolonës **a** me shprehjet që i përshtaten nga kolona **b**:*

kolona a	kolona b
Në sexhde them	Subhane rab-bijel Adhim
Në ruku them	Subhane rab-bijel aë'la
Midis dy sexhdeve them	Semiall-llahu limen hamideh
Gjatë ngritjes nga rukuja them	Rabigfirli
	Allahu Ekber

b) *Plotëso vendet bosh.*

Pasi mbaroj namazin jap selam: Es-selamu…….....……

c) *Shkruaj fjalitë e mëposhtme:*

- ***Veproj në rekatët e mbetur siç veprova në dy rekatet e parë.***
- .....
- .....



a) *Shpjegojua nxënësve se gjymtyrët me të cilat bihet në sexhde janë 7 dhe ato janë: "Fytyra bashkë me hundën, dy duart, dy gjunjët, dhe gishtat e këmbëve."*
b) *Sqarojua nxënësve se thënia tre here e duave në sexhde është e pëlqyeshme (sunet).*
c) *Sqaroju nxënësve mënyrën e dhënies së selam sipas mënyrës së të Dërguarit të Allahut.*



Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësi duhet të mësojë faljen e namazit, në mënyrë të saktë duke plotësuar kushtet dhe detyrimet e namazit.***
- ***Nxënësve duhet t'u qartësohet mënyra e ngritjes së duarve në tekbirin (fjala Allahu ekber) fillestar.***
- ***Nxënësit duhet të bëjnë dallimin se çfarë thuhet në ruku dhe çfarë thuhet në sexhde.***

Teshehudi



Et-tehij-jatu lil-lahi ues-salauatu uet-taj-jibatu, es-selamu alejke ej-juhen-nebij-ju ue rah-metull-llahi ue bereka-tuhu, es-selamu ‘alejna ue ‘ala ibadil-lahis-salihin. Eshhedu en la ilahe il-lAll-llah, ue esh-hedu en-ne Muham-meden abduhu ue resu-luhu.

Kur lexohet teshehudi ?

Teshehudi lexohet pas rekatit të dytë të namazit dhe quhet teshehudi i parë, lexohet edhe në rekatin e fundit të namazit dhe quhet teshehudi i fundit.

Diskutim:

a. *Plotëso vendet bosh me fjalët e mëposhtme:*



- ***Teshehudi i parë lexohet pas rekatit ……..……..***
- ***Teshehudi i fundit lexohet pas rekatit të ……***

b. *Vendos namazet që kanë një teshehud në kollonën* ***a*** *dhe namazet që kanë dy teshehude në kollonën* ***b****:*



a. *Shkruaj fjalitë e mëposhtme:*

- ***Unë pasoj imamin në të gjitha veprimet që bën ai në namaz.***
- .....
- ***Unë them "Allahu ekber" në fillim të namazit.***
- .....



a) *Qartësojua nxënësve mënyrën e mbajtjes së gishtit në namaz.*
b) *Mësojua nxënësve shqiptimin e teshehudit me një mënyrë që u përshtatet fëmijëve.*
c) *Shpjegojua se namazet me dy rekatë kanë një teshehud ndryshe nga namazet me 3 apo 4 rekatë.*

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësit duhet të mësojnë rëndësinë e teshehudit në namaz.***
- ***Nxënësit duhet të mësojnë përmendësh teshehudin.***
- ***Nxënësit duhet të mësojnë uljen e saktë në teshehud.***

Salavetet për të Dërguarin e Allahut (alejhi salatu ue selam)

● *Salavati për Profetin është :*

All-llahumme sal-li ‘alá Muhammedin ue ‘ala áli Muhammed, kema sal-lejte ‘alá Ibrahíme ue alá áli Ibrahím in-neke Hamídun Mexhíd.

All-llahumme barik ‘alá Muhammedin ue ‘alá áli Muhammed kema barekte ‘ala Ibrahíme ue ‘alá áli Ibrahím in-neke Hamídun Mexhíd.

- O Allah, mëshiroje Muhamedin dhe familjen e tij, siç mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij, se vërtet Ti je i Lavdëruar dhe i Madhërishëm.

- O Allah, bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç bekove Ibrahimin dhe familjen e tij, se vërtet Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar

Kur lexohet salavati?

Salavati lexohet pas leximit të teshehudit të fundit, para selamit.

Diskutim:

a) *Plotëso vendet bosh:*

All-llahumme sal-li alá ..... ue ‘ala áli Muhammed, kema sal-lejte ‘alá Ibrahíme ue alá áli ..... in-neke Hamídun Mexhíd.

All-llahumme barik ‘alá Muhammedin ue alá áli Muhammed ..... barekte ‘ala Ibrahíme ue alá áli Ibrahím in-neke ..... Mexhíd.


a. *Në mësim janë përmendur dy prej emrave të Profetëve cilët janë ato?*

b. *Rretho me laps përgjigjen e saktë:*

Salavati lexohet :

Pas rekatit të parë

Pas teshehudit të fundit



a) *Duhet që mësimi të zhvillohet në mënyrë praktike duke u shpjeguar nxënësve rëndësinë e teshehudit dhe të salavateve.*

b) *Tregojua nxënësve rëndësinë e salavateve për të Dërguarin e Allahut, kur e përmend vetë apo kur të tjerët e përmendin emrin e tij, duke sqaruar edhe shpërblimin për këtë veprim. I dërguari i Allahut (alejhi salatu ue selam) ka thënë: "Kush bën një salavat për mua, Allahu bën dhjetë salvate për të, i fshin dhjetë gjynahe dhe e ngre atë dhjetë gradë"*

Transmeton Nesaiu nr 1297.

Objektivat e mësimit:

- ***Nxënësi duhet të mësojë salvatet.***
- ***Nxënësit duhet t'i përkujtohet rëndësia e salavatit për Profetin (alejhi salatu ue selam) në namaz.***
- ***Nxënësi duhet të bëjë dallimin midis uljes në teshehudin e parë dhe uljes në teshehudin e dytë, me veprime praktike.***

Veprimet që e prishin namazin:

Namazin e prish:




Diskutim:

a. ***Umeri filloi të falë namazin dhe në gojë kishte një copë ëmbëlsire. Ai e hëngri atë. Pyetja shtrohet pas këtij veprim: A është i saktë namazi i Umerit ? Dhe pse?***

b. *Plotëso vendet bosh me fjalë të përshtatshme.*


E prishin abdesin dalja e .....,e ..... dhe gazrave.

c. *Ngjyros veprimet që e prishin namazin:*



a. *Shkruaj fjalitë e mëposhtme:*

- ***Nuk bëj asnjë veprim që e prish namazin gjatë faljes.***
- .....
- ***Është obligim përsëritja e namazit nëse namazi prishet me ndonjë veprim që e prish namazin.***
- .....
- .....
- ***Gjithmonë në namaz jam i pastër.***
- .....



a) *Duhet që mësuesi t'i qartësojë nxënësve kuptimet e fjalive që do t'i përmendim më poshtë:*
b) *Të jesh prezent me zemër gjatë faljes së namazit.*
c) *Gjërat që e prishin namazin dhe abdesin.*
d) *Lëvizjet e shumta në namaz.*

Objektivat e mësimit:

- ***Që nxënësve t'u përmenden disa nga veprimet që e prishin namazin.***
- ***Që nxënësi të bëjë lidhjen midis prishjes së abdesit dhe prishjes së namazit.***
- ***Që nxënësi t'u largohet veprimeve që e prishin namazin.***